Në bazë të nenit 12 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008 dhe nenit 25 pika 1 të Statutit të Komunës së Deçanit të datës 04.05.2010 dhe në pajtueshmëri me Ligjin nr.2004/18 mbi Tregtinë e Mbrendshme, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e vet të majtur me dt.30.03.2011, miratoi këtë:

# VENDIM

## PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR LEJE PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE AFARISTE

Pika 1.

Me këtë Vendim ndryshohet neni 4.3 i Rregullores për Leje për Ushtrimin e Veprimtarive Afariste me tekstin si në vijim:

4.3 Nëse subjekti afarist nuk e siguron brenda afatit të paraparë nga alineja 3 e këtij neni dëshminë përkatëse leja e punës do t'i vazhdohet për nga një vit gjithnjë deri sa të aprovohet Rregullorja komunale për trajtimin e objekteve pa leje ndërtimore.

Pika 2.

Për ekzekutimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim e KK Deçan.

Pika 3.

Ky Vendim hyn në fuqi pas miratimit në Kuvendin Komunal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

01.Nr.III-6
Deçan.dt.30.03.2011

Kryesuesi i Kuvendit:
Jashar Dobraj